

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER BLERTA D. KAÇELI



DATE 25/02/2021
NR REP 219

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25.02.2021, para meje Notere BLERTA D. KAÇELI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rr. "Myslym Shyri", Nr. 82, Tiranë, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Ina Prifti, atësia Stavri, amësia Valentina, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Sansa 03920251; Nd. 22; H. 1; Ap. 25; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 27/06/1990, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036726009 dhe nr. personal J05627087I.

Luan Gjomema, atësia Bilbil, amësia Fize, shtetas Shqiptar, lindur në Tragjas, Vlorë dhe banues në VLORË, me adresë Sulejman Delvina 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; Vlorë; Vlorë; 9402; Vlorë, lindur më 13/09/1955, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036403287 dhe nr. personal F50913096G.

Te cilet me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres aktet e mëposhtme:

1. "Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Smart Konstruksion" shpk.
2. "Akt Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Smart Konstruksion" shpk.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

BLERTA D. KAÇELI

Blerta Kaçeli



STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k.

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1 Shoqëria “SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”), krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti, Aktit të Themelimit, nga dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “ (të ndryshuar), Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“ (të ndryshuar), si dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është “SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria “SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Ndertim, zbatim të kategorive të specializuara të punimeve të ndryshme të ndertimit, punime dheu, sistemime taracash, ndertime civile, ndertime vepra arti, rikonstruksion godinash, prodhim materiale ndertimi.
- Ndertim gazsjellsi, naftesjellsi.
- Imp-eks tregetim të materialeve të ndryshme ushqimore, industrial, materiale ndertimi, konfeksione.
- Zyre shitblerje kancelari.
- Ndertim vepra industriale. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha. Ndertim diga dhe tunele. Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.
- Ndertim i impianteve për prodhim të energjise elektrike. Ndertime për N/stacione, kabinet e transformatoreve, linja e TN e të mesem.
- Punime të inxhinierise së mjedisti.
- Punime për prishjen e ndertimeve.
- Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri. Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastic, metalik dhe xhami.
- Impiante të sinjalistikes ndricuese të trafikut. Sinjalistike rrugore jo ndricuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore.
- Ndertim parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- Punime strukturore special. Punime mbi shina dhe tranversa. Impiante teknologjike termike dhe të konisionimit.
- Linja telefonike dhe të telekomunikacionit. Linja telefonike dhe të telekomunikacionit. Impiante të brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.
- Ndertim i impianteve të ujit të pijshem dhe pastrimit të tij.







Ndërtim I impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike.

Shpime gjeologjike – inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Ndërtim ujesjellsa, kanalizime të ujerave të zeza e të bardha, vepra kullimi dhe vaditje.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Rr. “Tefta Tashko”, pll.20, hyrja 14, ap.16, Tiranë.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vënd tjetër bëhet me Vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria është themeluar më dt. 24/02/2021. Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është e papërcaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të përcaktojë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100 (njëqind) lekë**.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Znj. Ina Prifti**, shtetase Shqiptare, e bija e Stavri, lindur në Fier, më 27.06.1990, banuese në Rruga “SANSÀ 03920251; Nd. 22, H. 1, Ap. 25, KASHAR, YZBERISH, 1050, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me Nr.036726009, Nr.personal J05627087I, dt.14.12.2020, zotron një kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.**;
- **Z. Luan Gjomema**, shtetas Shqiptar, i biri i Bilbil, lindur në Tragjas, më 13.09.1955, banues në Rruga “SULEJMAN DELVINA 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; VLOREË; VLOREË; 9402; mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.036403287, Nr.personal F50913096G, dt.09.09.2020, zotron një kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.**;

Neni 8 – Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 8.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



8.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

8.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

9.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

9.3 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme, si me pagesë ashtu edhe gradis në kuptimin më të gjërë të fjalës, duke përfshirë kështu dhurimin e kuotave të shoqërisë në favor të personave jo ortak, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.

9.4 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.

9.5 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

9.6 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

9.7 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

9.8 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi.

9.9 Pjesët e kapitalit të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë *mortis causa*. Në rast të vazhdimit të Shoqërisë me shumë pasardhës të ortakut të vdekur, ata duhet të emërojnë një përfaqësues të zakonshëm.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 10 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

10.1 Organi i vetëm vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

10.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proçedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 11.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij me të drejtë vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 11.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, ortak, apo person i tretë, i pajisur me autorizim me shkrim ose prokurë, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 11.3 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 11.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 3 (tre) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 12.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit ose nga ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008.
- 12.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me shkresë ose postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës

dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

12.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

12.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

12.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

12.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

12.8 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

12.9 Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

12.10 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

12.11 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

12.12 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 13 – Kuorumi

13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008.

13.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14 - Marrja e vendimeve

[Signature]

[Signature]

14.1 Asambleja e përgjithshme vendos mbi ndryshimet në Statut, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë me $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 dhe pikën 1 të nenit 13 të këtij Statuti.

14.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Neni 15- Përfshirja nga e drejta e votës

15.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:


- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

15.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16 – Administrimi

16.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) **Administrator i vetëm, Luan Gjomema**, shtetas Shqiptar, i biri i Bilbil, lindur në Tragjas, më 13.09.1955, banues në Rruga "SULEJMAN DELVINA 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; VLORË; 9402; VLORË.

Specimenët e nënshkrimit:





16.2 Kohëzgjatja e detyrës së administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

16.3 Administratori i vetëm i Shoqërisë ka fuqi të kryej të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin normal të shoqërisë me përjashtim të të drejtave që i janë njohur Asamblesë së Përgjithëshme.

16.4 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:



- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 16.5 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:
- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
 - b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) Shoqëria brënda 2 viteve të para të regjistrimit të saj, propozon të blej nga në ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qinde të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 16.6 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.
- 16.7 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 16.8 Administratori mund të heqë dorë në cdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyje në fuqi.
- 16.9 Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

- 16.10 Dorëheqja e administratorit nuk çënon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.
- 16.11 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 16.12 Shpërblimi që i jepet Administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të Shoqërisë.

Neni 17 - Përgjegjësitë e Administratorit

- 17.1 Administratori i Shoqërisë është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkelje të ligjit, të këtij statuti, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- 17.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 (të ndryshuar), administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 (të ndryshuar);
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 17.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 17.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 17.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;

Prof

[Signature]

- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 17.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.
- 17.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asambles nuk mund të ndalojë ngritjen e padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 18–Ndalimi i konkurrencës

- 18.1 Ortakët dhe administratori i Shoqërisë nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë “**SMART KONSTRUKSION**” sh.p.k. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
- 18.2 Ndalimi i sipër përmëndur shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posacëm, të dhënë nga ortakët, sipas dispozitave të nenit 36 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (të ndryshuar), apo nga Asambleja e Përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të po këtij ligji.
- 18.3 Ky ndalim mbetet në fuqi edhe për një periudhë një vjecare pas humbjes së cilësive apo statusit që administratori apo ortakët gëzojnë në Shoqëri.

Neni 19 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 19.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ekspertit kontabël të autorizuar.
- 19.2 Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja dorzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar.
- 19.3 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 20 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 20.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 20.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor.




- 20.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e votave të ortakëve (shumicë që përfaqëson më shumë se 1/2 e kapitalit të shoqërisë).
- 20.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 3 (tre) muajve që nga dita e mbylljes së vitit financiar.

Neni 21 – Fitimet

- 21.1 Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotruara.
- 21.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KAPITULLI V
SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Neni 22 – Prishja

- 22.1 Shoqëria priset:
- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me perfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (të ndryshuar);
 - e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g) për cdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 22.2 Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "e" dhe "g", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 (të ndryshuar).

Neni 23 – Likuidimi

- 23.1 Shoqëria hyn në likuidim në momentin e prishjes së saj. Ortaku i vetëm dhe/ose Asambleja e ortakëve do të përcaktojë modalitetet e likuidimit si dhe do të emërojë një ose më shumë likuidatorë.
Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave ligjore.

Neni 24 – Mardhëniet e punës

- 24.1 Mardhëniet e punës midis Shoqërisë dhe të punësuarve do të përcaktohen nga kontrata individuale dhe/ose kolektive e punës. Për ato çka nuk parashikohet në këto kontrata do të zbatohet legjislacioni ekzistues i punës.

Neni 25 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 25.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti apo akteve të tjera të Shoqërisë, ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se ky nuk arrihet, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 26 – Gjuha


- 26.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k.

Z. Arif Gjoni


Znj. Ina Prift




**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SMART KONSTRUKSION” Sh.p.k.**

Sot më datë 24 Shkurt 2021,

- **Znj. Ina Prifti**, shtetase Shqiptare, e bija e Stavri, lindur në Fier, më 27.06.1990, banuese në Rruga “SANSÀ 03920251; Nd. 22, H. 1, Ap. 25, KASHAR, YZBERISH, 1050, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me Nr.036726009, Nr.personal J05627087I, dt.14.12.2020, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit** të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.;
- **Z. Luan Gjomema**, shtetas Shqiptar, i biri i Bilbil, lindur në Tragjas, më 13.09.1955, banues në Rruga “SULEJMAN DELVINA 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; VLORË; VLORË; 9402; VLORË, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.036403287, Nr.personal F50913096G, dt.09.09.2020, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit** të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.;

kanë vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë “Shoqëria”), në bazë të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit“ (të ndryshuar) dhe ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (të ndryshuar).

Neni 1 - Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.

Neni 2 - Selia

- 2.2 Selia e Shoqërisë është në Rr. “Tefta Tashko”, pll.20, hyrja 14, ap.16, Tiranë.


Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria është themeluar me dt. 24/02/2021. Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është e papërcaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të përcaktoj kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Shoqëria “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Ndertim, zbatim te kategorive te specializuara te punimeve te ndryshme te ndertimit, punime dheu, sistemime taracash, ndertime civile, ndertime vepra arti, rikonstruksion godinash, prodhim materiale ndertimi.
- Ndertim gazsjellsi, naftesjellsi.

Ina Prifti 



- Imp-eks tregetim te materialeve te ndryshme ushqimore, industrial, materiale ndertimi, konfeksione.
- Zyre shitblerje kancelari.
- Ndertim vepra industrialesh. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha. Ndertim diga dhe tunele. Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.
- Ndertim i impianteve per prodhim te energjise elektrike. Ndertime per N/stacione, kabinat e transformatoreve, linja e TN e te mesem.
- Punime te inxhinierise se mjedesti.
- Punime per prishjen e ndertimeve.
- Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri. Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri, plastic, metalik dhe xhami.
- Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut. Sinjalistike rrugore jo ndricuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore.
- Ndertim parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- Punime strukturore special. Punime mbi shina dhe transversa. Impiante teknologjike termike dhe te konisionimit.
- Linja telefonike dhe te telekomunikacionit. Linja telefonike dhe te telekomunikacionit. Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.
- Ndertim i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij.
- Ndertim i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike.
- Shpime gjeologjike – inxhinierike, puse e shpime per uje.
- Ndertim ujesjellsa, kanalizime te ujerave te zeza e te bardha, vepra kullimi dhe vaditje.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100 (njëqind) lekë.**

Neni 6 - Kontributet

- 6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- **Znj. Ina Prifti**, shtetase Shqiptare, e bija e Stavri, lindur në Fier, më 27.06.1990, banuese në Rruga “SANSa 03920251; Nd. 22, H. 1, Ap. 25, KASHAR, YZBERISH, 1050, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me Nr.036726009, Nr.personal J05627087I, dt.14.12.2020, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.;**
 - **Z. Luan Gjomema**, shtetas Shqiptar, i biri i Bilbil, lindur në Tragjas, më 13.09.1955, banues në Rruga “SULEJMAN DELVINA 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; VLORË; VLORË; 9402; VLORË, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.036403287, Nr.personal F50913096G, dt.09.09.2020, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “SMART KONSTRUKSION” sh.p.k.;**

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 7.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Ina Prifti

Luan Gjomema

Neni 8 – Administratori


- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë personi i mëposhtëm:
- Z. Z. Luan Gjomema**, shtetas Shqiptar, i biri i Bilbil, lindur në Tragjas, më 13.09.1955, banues në Rruga “SULEJMAN DELVINA 04140424; Nd. 37; H. 12; Ap. 15; VLORË; VLORË; 9402; VLORË, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.036403287, Nr.personal F50913096G, dt.09.09.2020, i cili ka të drejtë të ushtrrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14 janar 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtar” (të ndryshuar).
- 8.2 Kohëzgjatja e detyrës së administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
- 8.3 Administratori i vetëm i Shoqërisë ka fuqi të kryej të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin normal të Shoqërisë me përjashtim të të drejtave që i janë njohur Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.5 Administratori i Shoqërisë është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkelje të ligjit, të këtij statuti, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- 8.6 Shpërblimi që i jepet Administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Neni 9 Ndalimi i konkurrencës

- 9.1 Ortakët dhe administratorët e Shoqërisë nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në Shoqëri të tjera, që ushtrjnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë “**SMART KONSTRUKSION**” sh.p.k. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
- 9.2 Ndalimi i sipër përmëndur shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët, sipas dispozitave të nenit 36 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (të ndryshuar), apo nga Asambleja e Përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të po këtij ligji.
- 9.3 Ky ndalim mbetet në fuqi edhe për një periudhë një vjecare pas humbjes së cilësive apo statusit që administratori apo ortakët gëzojnë në Shoqëri.

Neni 10 Viti financiar

- 10.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

Ina Prifti




- 10.2 Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor 2009.



Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Akti Themelimi apo akteve të tjera të Shoqërisë, ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se ky nuk arrihet kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 12
Gjuha

- 12.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 24 Shurt 2021

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SMART KONSTRUKSION” sh.p.k

z. Luay Jomeca
[Signature]

z. Ina Prifti
[Signature]